



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
07.05.2025

Me datë 07.05.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Jona Leqejza, Uarda Gjekaj, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Gëzim Galiqi, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Gjovalin Ndoj, Florian Bjanku, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Artan Haxhi, Irma Kopliku, Valjeta Bajraktari, Elis Doçi, Ardit Behri, Gjenarin Kapcari, Fatmir Vojvoda, Imeldi Sokoli, Muharrem Shkjau, Amila Lici.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Projektvendim: “Për miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit tip ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe distributorëve vendas dhe të huaj për shfaqjen e prodhimeve audiovizuale në Kinema “Republika”.*
2. *Projektvendim: “Për miratimin e kërkesës për transferim në pronësi, të pasurisë me Nr.2/170, Vol 9, faqe 140, ZK 8591 nga Ministria e Financave tek Bashkia Shkodër”.*
3. *Projektvendim : “ Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare “Bio Strajca”, në pronësi të Bashkisë Shkodër”*
4. *Projektvendim: “Për dhënien e të drejtës dhe caktimin e përgjegjësisë së menaxhimit, administrimit dhe mirëmbajtjes së plazheve publike të menaxhueshme për shoqërinë aksionere në pronësi të Bashkisë Shkodër me nipt M369240030”.*
5. *Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar dhe detajim të fondeve sipas aktit normativ Nr.5 datë 19.12.2024 të Ministrisë së Financave”.*
6. *Projektvendim: “Për miratimin e planit “Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për vitin 2025”.*



7. *Projektvendim: "Për miratimin e "Planit të përbashkët të menaxhimit të rrezikut nga zjarri" në kuadër të projektit " Bulding Smart Forests" .*
8. *Projektvendim: "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar".*
9. *Projektvendim: "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Shkodër për vitet 2026-2028".*
10. *Projektvendim: "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Shkodër".*
11. *Projektvendim: "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër".*
12. *Projektvendim: " Për miratimin e memorandumit të bashkëpunimit mbështetje për zhvillim 2023-2024 projekti "Bashki të forta"- Bashkia Shkodër"*
13. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është prezent në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Z. Luli shprehet se kjo është mbledhje vazhduese e asaj të kaluar, pasi nuk pati kourum dhe rendi i ditës është i njëjti dhe do vazhdojë aty ku u ndërpre. Ai vijon përsëri me citimin e rendit të ditës. Ai shton se ka një kërkesë për shtesë në rendin e ditës : *Pr/Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Prill 2025"*.

Z.Bjanku merr fjalën dhe thotë se faktikisht sot jemi mbledhur në një mbledhje jashtë rradhe pasi është pas një muaji nga mbledhja e kaluar. Dhe këtu ai citon rregulloren e Këshillit bashkiak, pikërisht nenin 41, pikën 2 të saj. Kurse për mbledhjet jashtë rradhe citon nenin 43 të rregullorës, ku tregohen rastetse kur mblidhet Këshilli bashkiak jashtë rradhe, pika 2. ku thuhet se kërkesa duhet paraqitur me shkrim dhe e firmosur, ku specifikohet arsyeja e mbledhjes dhe qëllimi i saj. Pra, shton ai jemi në kushtet e një mbledhjeje jashtë rradhe dhe nuk na është paraqitur asnjë kërkesë me shkrim, që justifikon mbledhjen e sotme. Nisur nga mbledhja e kaluar, ku një pjesë e pozitës, nisur nga shkaqe elektorale që parashikohen edhe nga dispozita të Kodit zgjedhor që ndalojnë mbledhjet, kur lidhen me element që prekin garën e ndershme. Ndërkohë jemi thirrur tre ditë para zgjedhjeve dhe nuk e kuptoj pse ka ndodhur kjo? Për propogandë a diçka tillë? Gjithsesi për të konkluduar jemi para një fakti të tillë, ku mund të marrim në konsideratë që jemi para pr/vendimit për ndihmën ekonomike. Ne biem dakort që kjo pikë të kalojë për miratim, pasi është e rëndësishme por përsa i përket pikave të tjera të rendit të ditës, mendojmë që mund të presin duke patur parasysh edhe argumentimin e pjesës tjetër të këshilltarëve sepse kanë element paligjshmërie dhe nuk mund të kalohen për votim. Pra vota nuk e bën një akt të paligjshëm, të ligjshëm siç është rasti i pr/vendimit për menaxhimin e plazheve publike.

Plazhi publik natyrisht, shton ai nuk mund të jetë asnjëherë me kosto për qytetarët, plazhi duhet të jetë jashtë çdo kostoje, të mirëmbahet dhe të lihet mundësia për të vazhduar sezoni. Për këtë ne kemi miratuar buxhetin dhe nuk ka asnjë pengesë që ndalon Bashkinë që të kryejë shërbimet dhe detyrimet e saj. Kurse për pikat e tjera ne jemi të gatshëm kurdoherë, pasi të bien të gjitha pengesat

që dikton Kodi zgjedhor për raste të tilla. Prandaj propozojmë që të hiqen 12 pikat e para të rendit të ditës dhe të lihet si pikë e vetme miratimi i Ndihmës ekonomike.

Z.Luli sqaron edhe njëherë duke theksuar edhe njëherë që kjo është një mbledhje vazhduese duke cituar këtu nenin 45 të rregullores së Këshillit bashkiak për raste të tilla. Ai shton se herën e kaluar u miratuan pesë pikat e para dhe më pas me kërkesë të kualicionit BF u kërkuan 5 minuta pushim dhe pas pushimit u rikthyet me vendim për largim nga salla. Në kushtet e mospatjes së kourumit, unë ndërpreva mbledhjen, dhe kjo është e pasqyruar edhe në procesverbalin e mbledhjes. Prandaj kjo nuk është mbledhje jashtë rradhe.

Z.Bjanku pyet se në çfarë date ka në mbledhja?

Përgjigjet **Z.Luli** duke thënë se me datë 08.04.2025 është mbajtur mbledhja e kaluar.

Pra, vazhdon **Z.Bjanku** nuk jemi në fund muaji....

Sqaron **Z.Luli**, që jemi mbledhur edhe herë të tjera jashtë kësaj kohe. Këshilli mund të mblidhet edhe disa herë në muaj.

Z.Bjanku replikon duke thënë se ky nuk është argument...

Z.Luli përsëri thotë se mbledhje është ndërprerë për mungesë kourumi.

Përsëri **Z.Bjanku**, mbledhja është ndërprerë për faktin që jemi në fushatë zgjedhore dhe për të njëjtat kushte që jemi mbledhur sot.

Për cilat kushte e keni fjalën, pyet **Z.Luli**.

Z.Bjanku, kjo u argumentua nga një pjesë e këshilltarëve të pozitës.

Z.Luli thekson , që ju, si grup e patë të arsyeshme të largoheshit nga salla dhe për mungesë kourumi unë mbylla mbledhjen.

Z.Bjanku përsëri, kourumi nuk u bë pasi kishte arsye pse nuk kishin ardhur këshilltarët. Pra ishim në kushte paligjshmërie.

Z.Luli thotë se rendi i ditës u miratua nga ju, ku qëndron këtu paligjshmëria?

Përsëri replikon **Z.Bjanku**, paligjshmëria është Kodi zgjedhor Z.Kryetar, që thotë se mbledhje të tilla, që lidhen me menaxhim fondesh, të cilat ndikojnë në fushatë... (citon këtu Kodin Zgjedhor)

Përsëri **Z.Luli** pyet se në cilën pikë kemi shkelje të ligjit?

Z. Bjanku thotë se iniciativa erdhi nga këshilltarët e pozitës...

Z.Luli përsëri kërkon të dijë se ku çenohet ligji këtu? Ai i kërkon **Z.Bjanku** tërilexijë edhe njëherë, për interes të qytetarëve.

Ndërhyn këtu **Znj.Nika** duke kërkuar që të vijohet me pr/vendimet.

Z.Luli shprehet se nuk po sillni asnjë argument. Ai shton se në asnjë pikë të Kodit zgjedhor nuk gjendet ndonjë pikë që prek apo cënon fushatën zgjedhore.

Përsëri **Z.Bjanku** i drejtohet **Z.Luli** duke thënë se duke qënë se ju jeni këshilltar më i hershëm se unë , më gjeni ju lutem një rast që Këshilli bashkiak është mbledhur tre ditë para zgjedhjeve.

Z.Luli i kërkon që të mos keqpërdorë ligjin . ai shton se si këshilltar keni të drejtën e fjalës por nuk mund të keqpërdorni ligjin për këtë.

Z.Ndou ndërhyr dhe i kërkon Kryetarit , të vazhdohet me mbledhjen.

Fjalën e merr **Z.Gjovalin Ndoj**, i cili deklaron që nga ky moment ai nuk do jetë më pjesë e grupit të Partisë Social Demokrate për arsye se ai dëshiron të mbështesë projektet e Bashkisë Shkodër duke u bërë pjesë e Partisë Socialiste.

Z.Ndou si fillim thotë se vlerëson dhe falenderon kolegun parafolës, i cili është bërë pjesë e grupit të PS.

Ndërhyr **Z.Bjanku** duke thënë se këtu jemi për procedurë nuk lejohet fjala... se po dilet jashtë teme.

Z.Luli sqaron se për procedurë iu dha fjala...

Vijon me fjalën e tij **Z.Ndou** duke thënë se sot kemi disa Pr/vendime shumë të rëndësishme, të cilat kanë një muaj që i kemi shtyrë në kohë dhe që nuk bien ndesh me procesin zgjedhor. Prandaj iu bëj thirrje që të vazhdojmë me mbledhjen, sepse çdo ditë që kalon është në dëm të sezonit turistik që presim të fillojë.

Ndërhyr **Znj.Shala....**

Përsëri **Z.Luli** i kërkon që të mos ndërpritet fjala e kolegut...

Znj.Shala shprehet se pr/vendimi i Ndihmës ekonomike nuk është në rendin e ditës që keni paraqitur...

Z.Luli sqaron se pr/vendimi per Ndihmën ekonomike është shtesë në rendin e ditës. Materiali është dërguar dhe ju jeni njohur me të.

Përsëri **Znj.Shala** thotë se propozon që 6% i Ndihmës ekonomike të jetë pika e parë si çdo herë tjetër. Ajo shton se u tha më parë që pr/vendimet nuk bien ndesh me ligjin dhe kjo nuk është aspak e vërtetë. Ajo shprehet se pr/vendimet i bien ndesh ligjit pasi jemi para zgjedhjeve dhe se disa prej tyre po përdoren për të blerë vota etj, etj.

Z. Luli pyet si mund të shërbejë pr/akti për korrupsion...?

Vazhdon **Znj.Shala** duke shtuar se po flasim për Velipojën ... Është miratuar tashmë fondi për mirëmbajtjen dhe pastrimin e Velipojës. Pse nuk është bërë deri tani?

Ajo shton se po kërkohet një pronësi... në një kohë që pa e kaluar ne si pr/vendim kryeministri e përdori për fushatë elektorale. Për më tepër ajo kërkon që pr/vendimi për ndihmën ekonomike të jetë pikë e parë e rendit të ditës së sotme.

Z.Luli përgjigjet se meqënëse iu referuat rregullores po ju citoj nenin 47, pika 7, ku flitet për pikat

shtesë të rendit të ditës.

Përsëri **Z.Bjanku** thotë se ai bëri një propozim, heqjen e 12 pikave të tjera nga rendi i ditës, në mënyrë që ndihma ekonomike të mbetet pikë e vetme. Nga ana tjetër në nenin 47 të rregullores, thotë ai thuhet se rendi i ditës nuk duhet të ketë më shumë se 10 pika .

Përsëri **Z.Luli** pyet pse nuk e keni propozuar këtë herët e tjera?

Kalohet në votimin e rendit të ditës pa ndryshime, ku rezultojnë **21** vota Pro 11 Kundër **0** Abstenim.
Miratohet

Hidhet në votim edhe propozimi i **Z.Bjanku**, për heqjen e 12 pikave të rendit të ditës, ku rezultojnë **13** vota Pro **18** Kundër **0** Abstenim. **Nuk Miratohet**

Përsëri merr fjalën **Znj.Shala**, duke propozuar që pr/vendimi për ndihmën ekonomike të kalojë si pikë e parë në rendin e ditës. Dhe shprehet se nëse jeni këtu për të mirën e qytetarëve duhet ta hidhni në votim.

Znj.Nika thotë se tashmë rendi i ditës u miratua dhe nuk mund të bëhen më ndryshime sepse po bëhemi qesharakë.

Z.Shkjau merr fjalën dhe shprehet se nuk jemi mbledhur të merremi me lojra fjalësh. Nëse kolegët këshilltarë e kanë vendosur që të bojkotojnë mbledhjen dhe të mos ndjekin rendin e ditës ta mbyllim e të mos diskutojmë kot. Ai shton se e di që të dyja palët në prag zgjedhjesh kërkojnë të dalin mirë në Tv, por qëndrimi duhet treguar me votë e jo me llafe.

Znj.Kavaja shprehet se do i lutesha të gjithë kolegëve këshilltarë që së paku pr/vendimet duhen diskutuar, të bëhen propozime ose të mbajmë qëndrimin tonë secili nga ne dhe ta shprehim me votë.

Znj.Shala insiston përsëri që pr/vendimi për ndihmën ekonomike të jetë pikë e parë.

Përsërit **Z.Luli** duke thënë se u miratua rendi i ditës së sotme...

Vijon **Znj.Shala** duke thënë se duhet ta hidhni në votë pasi në të kundërt kjo do të thotë se nuk doni që kjo pikë të miratohet. Ajo shton se grupi jonë nuk do bëhet pjesë e pr/vendimeve të paligjshme.

(Grupi i Kualicionit BF, largohet nga salla)

Znj.Petani shprehet se ne nuk jemi këtu për të plotësuar tekat e askujt. U kuptua që në fillim që kolegët e BF-së kishin ardhur për të bërë politikë dhe për të braktisur sallën.

Z.Luli sqaron se në sallë janë aktualisht 21 këshilltar prandaj nuk mund të merren vendime por në qoftë se ka pyetje, administrata e Bashkisë mund t'i përgjigjet duke qenë se janë prezent.

Znj.Kavaja merr fjalën përsëri dhe shprehet se do donin të kishin një sqarim më shumë për qytetarët dhe opinionin publik për pr/vendimet më të rëndësishme, që me të padrejtë u gjykan si politikë apo se prekin fushatën zgjedhore. Sidomos përsa i përket plazhit të Velipojës do donim të dinim më shumë, duke qenë se është keqkuptuar që nuk do ketë hapësira publike, por në fakt do jetë krejt e

kundërta. Po të shohim pr/vendimin e paraqitur mund të kuptohet qartë që hapësirat për plazhe publike janë shtuar.

Zv/Kryetari z.Beka shprehet se realisht është për të ardhur keq për kolegët, që nuk morën as mundimin për të dëgjuar sqarimet mbi pr/vendimin në fjalë, në një rast ku bëhet fjalë për një menaxhim krejtësisht ndryshe dhe me shumë vizion për plazhin e Velipojës. Ai bën edhe një analizë të detajuar për këtë pr/vendim.

Fjalën e merr **Znj.Nika**, e cila shprehet se përpos benefiteve dhe vlerave të shtuara që sjell ky pr/vendim është edhe sensitiv për shkak të problematikave të vazhdueshme që ka patur plazhi i Velipojës kur disa hapësira kanë mbetur pa lidhur kontratë, gjë që ka sjellë edhe konflikte. Ajo që dua të theksoj, shtoj ajo është fakti që më në fund po i jepet një zgjidhje përfundimtare zaptimit të hapësirave në Velipojë me abuzime dhe në çmime. Prandaj në momentin që Bashkia Shkodër merr në administrim hapësirat publike, ajo bëhet e konkurueshme në çmime të përballueshme për shumë qytetarë. Për më tepër disa pika të ndryshuara janë rekomandime të lëna nga KLSH-ja. Prandaj është e mira që t'i referohemi dokumentave ligjore e të mos flasim në absurditet me keqdashje. Duhet të sqarojmë qytetarët që nëse deri vjet 70% e plazhit ka qenë privat, sivjet do ketë 60% plazh publik. Pse nuk i jepet njëherë e mirë zgjidhje interesit të qytetarëve?

Tjetër prioritet i këtij pr/vendimi është që me këto ndryshime rritet edhe numri i personave që do punësohen për menaxhim dhe mirëmbajtje, prandaj ky nuk është aspak një pr/vendim politik. Duhet t'i jepet zgjidhje njëherë e mirë atij plazh dhe me tarifa të përballueshme për të gjithë.

Edhe **Z.Ndou** shprehet se është tashmë hera e dytë që kolegët demokratë braktin sallën e Këshillit. Dhe kjo nuk është në të mirë të qytetarëve tq Shkodrës por vetëm për qëllime vetjake dhe elektorale. Qytetarët e Shkodrës duhet të jenë të vëmendshëm dhe ta kuptojnë situatën në të cilën gjenden sot, sepse të braktisësh tre pr/vendime shumë të rëndësishme për qytetin, sidomos tani në prag të sezonit...

Qytetarët e Shkodrës me 11 Maj duhet të vlerësojnë këtë moment dhe të bëhen pjesë e transformimit dhe punëve të mira që po bëhen për qytetin dhe jo të jenë pjesë e shkatërrimit apo bllokimit siç po bëjnë partitë e tjera politike.

Edhe **Z.Beka** në vazhdim të fjalës së Z.Ndou thotë se përveç pr/vendimit për Velipojën, një pr/vendim tjetër shumë i rëndësishëm ishte edhe ai për Kinema "Republika", pasi tashmë dihet se si e gjetëm atë godinë. E rikthyem në funksionin e saj kryesor që duhet të ketë, por sot ajo luan vetëm 20% të këtij funksioni dhe donim t'i jepnim mundësi më të mëdha dhe këtui nuk ka të bëjë aspak politika.

Znj.Mehmetaj shprehet se nuk dëshiron të hyjë në detaje se sa të rëndësishme janë pr/vendimet, por dëshiron t'i kujtojë të gjithë kolegëve këshilltarë, si atyre që braktisën sallën si edhe atyre që nuk erdhën fare, detyrën e një anëtarit të Këshillit bashkiak, që është përfaqësimi i qytetarëve dhe të jenë zëri i tyre. Përfaqësim do të thotë të marrësh pjesë në mbledhjet e Këshillit, të miratosh ose jo pr/vendime, por asnjëherë nuk bën pjesë në detyrat e një këshilltari të mungojë apo të mospërfaqësojë qytetarët. Të mos miratosh pika si ndihma ekonomike është e pafalshme. Po ashtu edhe pika të tjera shumë të rëndësishme nuk duhen përdorur politikisht. Uroj që qytetarët ta kuptojnë situatën dhe të gjendet një zgjidhje për këtë në vazhdim.

Përsëri **Znj.Petani** shprehet lidhur me largimin e këshilltarëve të BF-së nga salla, duke thënë se është e dhimbshme të mos miratohet 6%, dhe të na vihen kushte se cila pikë duhet të jetë e para apo e fundit në rend dite. Ne nuk jemi këtu për të plotësuar tekat e asnjërit. Tashmë pr/vendimet i njohim të gjithë dhe të mos nxjerrim justifikime të kota. Nuk mund të na tregojnë se kur duhet Bashkia Shkodër të fillojë punën me Velipojën, kjo është e turpshme, por qytetarët e shohin edhe dijnë të bëjnë diferencën. Nuk jemi këtu për politikë por në shërbim dhe në të mirë të popullit që na ka besuar.

Z.Shkja merr fjalën dhe shprehet se nuk duhet t'ia vemë fajin grupit të BF-së, sepse ky Këshill do ketë edhe probleme të tjera, do ketë mosbesime e shumë të tjera si këto. Duhet mirëkuptuar kolegët dhe të mos ta bëjmë politike sepse qytetarët nuk mund të penalizohen për punët e pakryera.

Z.Galiqi thotë se për ne fakti që është e dyta mbledhje që nuk po realizohet siç duhet është shqetësues. Pasi qytetarët e Shkodrës duhet të kenë shërbime dhe punë të kryera. Prandaj ai mendon s në Kryesinë e Këshillit duhet të arrihet një marrëveshje paraprakisht dhe një bashkëpunim para se të vijmë në mbledhje. Ai shton se retorika politike duhet të shmanget nga të dyja palët, pasi nuk i shërben qytetarëve.

Zv/Kryetari z.Preka merr fjalën dhe thotë se u bë e dyta herë që u mbajt i njëjti qëndrim, me argumentin se po çënohet ligji në fushatë zgjedhore, dhe kjo nnuk është e drejtë, po të mendojmë se kështu po vazhdojnë të penalizohen qytetarët e Shkodrës. Minimalisht duhet të jemi koherent dhe me argumenta të sakta duke parë gjithmonë interesin publik. Po të marrim pr/vendimin për Velipojën, bëhet fjalë për shtim hapësirash publike dhe një ulje pagese për qytetarët. U anashkalua edhe fondi për emergjencat civile, kjo është një shtesë në buxhetin e Bashkisë. Ai shton se kjo është e papranueshme dhe nuk ka aspak lidhje me fushatën dhe fton qytetarët që të tregohen të vëmendshëm të kuptojnë se gjithçka po ndidh këto dy mbledhje nuk ka lidhje me sa u pretendua, por është thjesht një bojkot dhe një moslejim për Bashkinë dhe administratën e saj, që ka bërë një punë të shkëlqyer për realizimin e këtyre projekteve që kanë një impakt direkt në jeyën e qytetit.

Edhe **Zv/Kryetaria znj.Qyteza** shprehet se ndjehet shumë e keqardhur për situatën e krijuar dhe në mënyrë të veçantë për mosmiratimin e Ndihmës ekonomike. Ajo thotë se nëse çdo pr/vendimi do mund t'i jepej një ngjyrë, ndihma ekonomike ka vetëm një ngjyrë , atë humane. Në ate listë përfituesish, shton ajo jane të përfaqësuara të gjitha shtrest më vulnerabël. Dhe ne sot për një kapriço politike nuk e miratua. Ajo thjesht mendon që kjo është një mosdashje për të kryer detyrën e këshilltarit, gjëja më elementare e secilit. Dhe beson se duhet t'ë ndihen keq ndaj personave që presin me padurim miratimin e këtij Pr/vendimi.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

*Në mungesë kourumi Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaroi mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 07.05.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 8 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e rradhës së Këshillit bashkiak.

Sekretar

Sabina DANAJ



KRYETAR

Oltion LULI



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti

